

LIGJ
Nr. 8952, datë 10.10.2002

PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK DHE DIGJITAL TË SHTETASVE
SHQIPTARË

(ndryshuar me ligjin nr.10 066, datë 2.2.2009 dhe nr.10 328, datë 30.9.2010, nr. 11/2019, datë 5.3.2019, me aktin normativ nr. 25, datë 10.6.2020¹, me ligjin nr. 89/2020, datë 9.7.2020; ndryshuar me aktin normativ nr. 11, datë 25.3.2021²; nr. 2, datë 2.3.2022³; nr. 1, datë 27.4.2023⁴; nr. 2, datë 5.2.2025⁵; ligjin nr. 6/2025, datë 30.1.2025; ndryshuar me aktin normativ nr. 5, datë 7.5.2025⁶)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

(shtuar fjalë me ligjin nr. 6/2025, datë 30.1.2025)

Ky ligj përcakton letërnjoftimin e shtetasve shqiptarë, me qëllim pajisjen e të gjithë shtetasve shqiptarë, personave pa shtetësi dhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një letërnjoftim unik, elektronik ose digjital, kriteret për lëshimin e tij, si dhe përmbajtjen e këtij letërnjoftimi.

Neni 2

(Shfuqizuar fjalia e dytë e pikës 1, dhe shtuar pikat 3, 4, 5, me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010; shtuar fjali në pikën 1, shtuar fjalë në pikën 4, ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 6/2025, datë 30.1.2025)

1. Letërnjoftimi i personave është dokumenti bazë, i përhershëm që shërben për identifikimin e shtetasve shqiptarë. Letërnjoftimi mund të jetë në formë elektronike ose digjitale. Në çdo rast, shtetasit mund të zgjedhin për t'u pajisur me një nga format e letërnjoftimit ose mund të pajisen njëkohësisht me letërnjoftimin në të dyja format, elektronike dhe digjitale.

2. Çdo shtetas duhet të mbajë me vete letërnjoftimin.

3. Shtetasi aplikon për letërnjoftim elektronik në zyrat e aplikimit.

4. Letërnjoftimi elektronik tërhiqet nga vetë shtetasi në zyrat e aplikimit.

5. Rregullat dhe procedurat për paraqitjen e kërkesës për pajisjen me letërnjoftimin elektronik e digjital, pajisja, si dhe dokumentet e nevojshme, që shoqërojnë kërkesën, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.

¹ Akti normativ nr. 25, datë 10.6.2020 është miratuar me ligjin nr. 87/2020, datë 9.7.2020.

² Akti normativ nr. 11 datë 25.3.2021 është miratuar me ligjin nr. 54/2021, datë 4.5.2021.

³ Akti normativ nr. 2, datë 2.3.2022 është miratuar me ligjin me ligjin 35/2022, datë 14.4.2022.

⁴ Akti normativ nr. 1, datë 27.4.2023 është miratuar me ligjin nr. 37/2023, datë 25.5.2023.

⁵ Akti Normativ nr. 2, datë 5.2.2025 është miratuar me ligjin nr. 14/2025, datë 27. 2.2025.

⁶ Akti normativ nr. 5, datë 7.5.2025 është miratuar me ligjin nr. 28/2025, datë 5.6.2025.

Neni 3

(Ndryshuar shkronja "a" e pikës 1 me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010)

1. Për pajisjen me letërnjoftim shtetasi duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:
 - a) të jetë i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
 - b) të ketë mbushur moshën 16 vjeç.
2. Çdo shtetas që plotëson kushtet e mësipërme është i detyruar të pajiset me letërnjoftim, brenda afateve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

(Ndryshuar me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010, shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 89/2020, datë 9.7.2020; bequr fjalë me ligjin nr. 6/2025, datë 30.1.2025)

Letërnjoftimi lëshohet me afat 10 vjet nga data e lëshimit.

Për shtetasit që kanë mbushur moshën 75 (shtatëdhjetë e pesë) vjeç, letërnjoftimi lëshohet pa afat.

Neni 5

(Shtuar shkronja "ç" me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010; ndryshuar me ligjin nr. 6/2025, datë 30.1.2025)

Shtetasi pajiset me letërnjoftim të ri kur plotëson kushtet e nenit 3 të këtij ligji dhe kur:

- a) njëri nga përbërësit e gjendjes civile, të pasqyruar në letërnjoftim, ka ndryshuar, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi; ose
- b) vërtetohet nga organet përkatëse se letërnjoftimi i ka humbur ose i është vjedhur; ose
- c) është dëmtuar; ose
- ç) në çdo rast tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 5/1

(Shtuar me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010; ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr. 6/2025, datë 30.1.2025)

Letërnjoftimi shpallet i pavlefshëm kur:

- a) ka të dhëna të mjaftueshme se mbajtësi i tij e ka siguruar në mënyrë të paligjshme;
- b) vërtetohen rastet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 6

(Ndryshuar me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010; numërtuar paragrafi i parë, shtuar fjalë, shtuar pika 2 dhe 3 me ligjin nr. 6/2025, datë 30.1.2025)

1. Letërnjoftimi elektronik është dokument identiteti, në të cilin janë pasqyruar qartë dhe shënuar me metoda informatike:

- a) përbërësit e gjendjes civile të shtetasit:
 - i) numri personal (nup);
 - ii) emri;
 - iii) mbiemri;
 - iv) shtetësia;
 - v) vendlindja;
 - vi) datëlindja;
 - vii) gjinia;

b) fotografia e mbajtësit të këtij dokumenti;
c) nënshkrimi i mbajtësit ose i kujdestarit ligjor;
ç) elemente sigurie, brenda normave të Komunitetit European, numri i të cilave caktohet nga Këshilli i Ministrave.

2. Letërnjoftimi digjital është dokument identiteti në të cilin janë pasqyruar qartë dhe janë shënuar me metoda digjitale të gjitha elementet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Përveç elementeve të pikës 1 të këtij neni, në letërnjoftimin digjital përfshihen edhe:

a) çelësi kriptografik, që mundëson identifikimin digjital dhe certifikatën përkatëse;
b) informacioni, i cili mundëson nënshkrimin digjital, duke përfshirë një çelës kriptografik, që mundëson nënshkrimin digjital dhe certifikatën përkatëse;
c) të dhëna të tjera teknike, të nevojshme për funksionimin ose përdorimin e identitetit digjital.

3. Të dhënat e tjera teknike, që përfshihen në letërnjoftimin digjital sipas shkronjës “c” të pikës 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6/1

(shtuar me ligjin nr. 6/2025, datë 30.1.2025)

1. Shoqëria aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike është përgjegjëse për:

a) krijimin e letërnjoftimit digjital dhe të infrastrukturës teknike e teknologjike për garantimin e sigurisë dhe të besueshmërisë së letërnjoftimit digjital;
b) administrimin e bazës së të dhënave shtetërore për letërnjoftimin digjital;
c) krijimin e kushteve për kryerjen e transaksioneve digjitale ndërmjet palëve të treta edhe nëpërmjet përdorimit të letërnjoftimit digjital.

2. Shoqëria aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike mund t'i përmbushë përgjegjësitë e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni vetë ose nëpërmjet shoqërive të tjera, që kanë eksperiencën dhe kapacitetet teknike e financiare për krijimin e letërnjoftimeve digjitale, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Neni 7

1. Shkelja e afateve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 5 000 lekë. Të drejtën për vendosjen e gjobës e ka shërbimi i gjendjes civile.

2. Mënyra e vendosjes së gjobës dhe ankimi në gjykatë bëhen sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.

Neni 8

Forma, modeli i letërnjoftimit dhe mënyra e shpërndarjes miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Ligji nr.4172, datë 13.9.1966 “Mbi pajisjen e shtetasve me letërnjoftim”, ndryshuar me ligjet përkatëse, si dhe të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010)

Tarifat për pajisjen dhe ripajisjen me letërnjoftim elektronik janë të përcaktuara në kontratën koncesionare, ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.7.2008. Me përfundimin e kësaj kontrate, këto tarifa do të jenë objekt i përcaktimit nga ky ligj.

Neni 9/1

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me ligjin nr. 11/2019, datë 5.3.2019)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimeve elektronike të shtetasve shqiptarë, të cilat janë lëshuar nga data 9.2.2009 deri në datën 31.12.2009 dhe që përfundon brenda vitit 2019, zgjatet deri në datën 31.12.2019.

Neni 9/2

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me me aktin normativ nr. 25, datë 10.6.2020)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve shqiptarë, që përfundon brenda vitit 2020, zgjatet deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.

Neni 9/2

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me aktin normativ nr. 11, datë 25.3.2021)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve shqiptarë, që përfundon deri në datën 25 prill 2021, zgjatet deri në datën 30 prill 2021.

Neni 9/3

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me aktin normativ nr. 2, datë 2.3.2022)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve, që parashikohen në listat e zgjedhësve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, të shpallura me dekretin nr. 13438, datë 20.1.2022, të Presidentit të Republikës, që përfundon deri në datën 6 mars 2022, zgjatet deri në datën 7 mars 2022.

Neni 9/4

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me aktin normativ nr. 1, datë 27.4.2023)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve, votues në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të shpallura me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, që përfundon deri në datën 14 maj 2023, zgjatet deri në datën 31 maj 2023.

Neni 9/5

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me aktin normativ nr. 2, datë 5.2.2025; shtuar fjalë me aktin normativ nr. 5, datë 7.5.2025)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik, që përfundon deri në datën 11 maj 2025, zgjatet deri në datën 31 maj 2025 për shtetasit me vendbanim brenda dhe jashtë vendit, votues në zgjedhjet për Kuvendin, të shpallura me dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, të Presidentit Republikës.

Kjo zgjatje e afatit të vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik ka efekt vetëm për ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur në datën 11 maj 2025.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3542, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**